



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Menaxhmenti Publik dhe Administrata (2018/2019)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180 / 240
Titulli	I diplomuar në menaxhmentin publik dhe administratë / Drejtimi: Menaxhimi i organizatave joqeveritare
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-1215/8
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-1259/3 (15.08.2018)
Vendimi për fillim me punë	03-1259/3 (15.08.2018)
Data akreditimit	16.05.2018

Përshkrimi i programit

Programi studimor Menaxhimi i organizatave joqeveritare ka qasje multidisiplinare të elementeve thelbësore të studimit në fushën e administratës publike, drejtësisë, shkencave socio-ekonomike, i përshkruan dhe i identifikon konceptet themelore, parimet, proceset administrative dhe juridike, si dhe teoritë në administratën publike, teoritë në administratën publike, të tilla si ato që kanë të bëjnë me sjelljen institucionale dhe njerëzore, procesin e politikave publike, ekonominë e sektorit publik dhe menaxhimin e organizatave publike dhe jofitimprurëse.

Qëllimet kryesore të programit janë përgatitja e studentëve për:

- Përgatitjen e dokumenteve administrative, planifikimin dhe koordinimin e punës ndërinstitutionale, arkivimin, regjistrimin i subjekteve administrative, duke i përdorur sistemet informative;
- Zbatimin e njohurive profesionale për përmbushjen e detyrave të punës në institucionet shtetërore dhe administratën publike, organizatat private, si dhe sektorin civil;
- Zhvillimin e mendimit kritik për punën e institucioneve shtetërore dhe publike në rastet e thyerjes së rregullave administrative, burokracisë dhe jo transparencës;
- Të fitojnë njohuri analitike për ta zhvilluar rolin e shtetit dhe të administratës publike në dekadat e fundit në Republikën e Maqedonisë dhe në shtetet e tjera rajonale;
- Të njohin trendet bashkëkohore dhe zhvillimet në institucionet shtetërore dhe publike dhe në menaxhimin publik në vendet në zhvillim dhe në ato të zhvilluara;
- Marrjen e nismave për identifikimin dhe adresimin e nevojave për studim në institucionet shtetërore dhe administratën publike;
- Të fitojnë kompetenca dhe aftësi për planifikimin strategjik, planet e veprimit, aplikimin për grante dhe shkrimin e projekteve;
- Përvetësime dhe shkathtësi për menaxhimin e projekteve dhe grumbullimin e fondeve në sektorin e OJQ-ve.

Karriera

Me të përfunduar studimet në këtë program, studentët mund të punësohen si menaxherë në sektorin publik dhe të menaxhojnë organizatat në sektorin joqeveritar.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Zhvillimi i njohurive të sektorit jofitimprurës: Të demonstrohet njohuria dhe të kuptuarit e tendencave të kaluara, aktuale dhe të ardhshme në sektorin jofitimprurës në organizata, politika dhe sektorë në Shtetet e Bashkuara dhe jashtë saj;
- Zhvillimi i vlerave të sektorit social: Të demonstrohen mendime strategjike, respektuese dhe kritike për artikullimin dhe njohjen e vlerave të sektorit social për promovimin e komuniteteve të drejta, gjithëpërfshirëse, prosperuese, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme;
- Ka njohuri dhe kuptim multidisiplinar të elementeve kryesore të studimit në fushën e sektorit të OJQ-ve, ligjit, shkencave socio-ekonomike;
- Ka njohuri për proceset e integritimit në Bashkimin Evropian dhe projektet për sektorin e OJQ-ve;

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aplikimi i kompetencave të menaxhimit jofitimprurës;
- Për të pranuar të dhëna të paarsyeshme për komplikime;
- Zbatimi i parimeve dhe qasjeve në menaxhimin jofitimprurës për të zgjidhur problemin me anë të planifikimit strategjik, menaxhimit të bordit, zhvillimit të resurseve, administrimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore, pajtueshmërisë ligjore, marketingut jo fitimprurës, vlerësimit të programeve, politikave dhe evokimit;
- Të menaxhojë institucionet nga sektori joqeveritar;
- Zbatimi i menaxhimit publik financiar;
- Shkrimi i projekteve dhe vlerësimi i projekteve në sektorin publik dhe në sektorin joqeveritar.

Aftësitë për të vlerësuar

- Integrimi i udhëheqjes etike jofitimprurëse: Demonstron kapacitetin etik të drejtimit dhe gjykimin etik për leadershipin jofitimprurës, llogaridhënien globale, përgjegjësinë sociale dhe vendimmarrjen etike;
- Analiza cilësore e procesit të projektit;
- Vlerësimi i ndikimit të projekteve në komunitet;
- Vlerësimi i projekteve në sektorin joqeveritar;

Aftësitë e komunikimit

- Është në gjendje të merr pjesë në debate, negociata dhe ndërmjetësime, duke siguruar analizë të argumentuar për diskursin politik;
- Posedon aftësi koherente për përpilim të propozim projekteve, analizave, koncepteve;
- Tregon aftësi për komunikim profesional me më tepër persona në atmosferë ekipore me qasje inkluzive;

Aftësitë e të mësuarit

- Integrimi i analizës së ndikimeve shoqërore;
- Demonstrimi i kapacitetit për të vlerësuar përfitimet e zhvillimit organizativ, të mësuarit organizativ, efektivitetin organizativ dhe qëndrueshmërinë organizative për ndikimin social dhe inovacionin social;
- Ka aftësi për të zbatuar të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vetë-edukimin në fushën e sektorit të OJQ-ve;
- Është në gjendje të trajnojë qytetarët për institucionet në sektorin publik dhe për shoqërinë demokratike, si dhe për sektorin joqeveritar;

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CPS-104] [6.0 SETK] **Teoria e shtetit dhe e së drejtës**
- [CPA-101] [6.0 SETK] **Hyrje në administrimin publik**
- [CPS-1011] [6.0 SETK] **Hyrje në Sociologji**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**

- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [CPA-302] [6.0 SETK] **Hyrje në politikat publike**
- [EPS-405] [6.0 SETK] **Hyrje në ekonomi**
- [CPA-501] [6.0 SETK] **Konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në sektorin publik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**

Semestri 3

- [CPA-403] [6.0 SETK] **Menaxhimi me burimet njerëzore në sektorin publik**
- [CPA-301] [6.0 SETK] **Bazat e statistikës**
- [CPA103] [6.0 SETK] **E drejta administrative dhe procedura administrative**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 4

- [CPA-201] [6.0 SETK] **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**
- [CPMPP-04] [6.0 SETK] **Sistemi i nëpunësve administrativ në RMV**
- [CPMPP-05] [6.0 SETK] **Buxhetimi dhe financat publike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 2**

Semestri 5

- [CPA-6033] [6.0 SETK] **Metodat kualitative dhe kuantitative në shkencat shoqërore**
- [CMNGO-05] [6.0 SETK] **Udhëheqja organizative në sektorin joqeveritar**
- [EPMPP-07] [6.0 SETK] **Menaxhimi i projekteve dhe menaxhimi i granteve**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 6

- [CMNGO-06] [6.0 SETK] **Menaxhimi financiar dhe efikasiteti në përdorimin e burimeve të organizatave të shoqërisë civile**
- [CPMPP-06] [6.0 SETK] **Menaxhmenti strategjik në sektorin publik dhe jofitimprurës**
- [CPA-604] [6.0 SETK] **Punim diplome**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 7

- [CPA118] [6.0 SETK] **Sistemet politike bashkëkohore**
- [CPMPP-08] [6.0 SETK] **Mirëqeverisja dhe përgjegjësia shoqërore**
- [CMNGO-07] [6.0 SETK] **Menaxhimi i konfliktit, shkathtësitë e komunikimit dhe negociimit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 8

- [CMNGO-08] [6.0 SETK] **Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i vullnetarëve**
- [CMNGO-09] [6.0 SETK] **Rregullimi ligjor dhe etika për organizatat e shoqërisë civile**
- [CMNGO-10] [6.0 SETK] **Sigurimi i fondeve për OJQ-të**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore

Description of courses

Lëndë obligative

- **Teoria e shtetit dhe e së drejtës**

Kjo lëndë studentëve ju ofron njohuri hyrëse teorike për konceptet dhe institutet kryesore në fushën e shtetit dhe të drejtës. Në mënyrë plotësuese program i lëndës është thelbësor për studimin e një vargu të lëndëve të tjera gjatë studimeve.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrimi publik përfshen një fushë me interes të veçantë për shkencën. Me lëndën Hyrje në administrimin publik studentët marrin njohuri mbi konceptet themelore të administrimit publik. Thëks i veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të administrimit publik si dhe reformave në këtë fushë në vendin tonë. Studentët do të kenë mundësi të njihen me këtë fushë dhe në mënyrë kritike të analizojnë zhvillimin dhe dukuritë në administrimin publik. Meqë kjo fushë është subjekt i ndryshimeve konstante, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet teorive të reja si dhe teorive klasike të administrimit publik. Subjekti i hulumtimit përbëhet nga: termet dhe njohuritë themelore lidhur me parimet dhe institucionet e administrimit publik; roli dhe rëndësia e administrimit publik në shoqërinë e organizuar; gjeneza dhe zhvillimi historik i administrimit publik; struktura organizative e administrimit publik; funksionimi i institucioneve të administratës publike; nëpunësit civilë; kontrolli dhe përgjegjësia e administrimit publik; komunikimi në administrimin publik; administrimi publik si shërbim për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut, etj.

- **Hyrje në Sociologji**

Lënda "Hyrje në Sociologji" duhet t'u sigurojë studentëve njohuri të përgjithshme për lëvizjet dhe ndryshimet shoqërore. Bëhet fjalë për një objekt që kryen përpunimin e disa lëvizjeve themelore sociale, duke filluar me ato të cilat të gjithë ne përballemi si qytetarë dhe akademikë. Studentët do të pajisen me një literaturë të plotë nga autorë vendas dhe të huaj, të cilët do t'u mundësojnë atyre të zgjerojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre në fushat e temave që janë subjekt i analizave. Si qëllime të veçanta të kësaj lënde mund të theksohen: -Studentët t'i kuptojnë konceptet dhe teoritë themelore sociologjike; -Studentët t'i kuptojnë kuadrin shkencor të sociologjisë; -Studentët do të jenë në gjendje të njohin paradigmat themelore dhe drejtimit në sociologji; -Studentët të krijojnë mendime kritike rreth sociologjisë si një sistem dinamik; -Studentët të ndërtojnë një qëndrim personal dhe kritik ndaj ndërveprimeve shoqërore në nivelin mikro, si dhe lidhjen e tyre me strukturën makro sociale; -Studentët t'i njohin aspektet sociale dhe kulturore të socializimit; -Studentët të krijojnë mendime personale rreth globalizimit dhe zhvillimit teknik dhe teknologjik dhe ndikimit të tyre në shoqëritë bashkëkohore;

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është një disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Hyrje në ekonomi**

Përmes kësaj lënde studentët do të njihen me rrethimin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes. Ndërkaq, kujdes do t'i kushtohet funksionit të financimit, marketingut dhe organizatimit të ndërmarrjes. Përveç kësaj, analizohet edhe ndikimi i ndërmarrjes në bashkësinë ku ajo vepron.

- **Konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në sektorin publik**

Studentët do të mund të njihen me aspektet fundamentale të menaxhimit publik si një fushë shkencore dhe si profesion si dhe të analizojnë aktivitetet e qeverisë nga perspektiva e së drejtës, menaxheriale dhe politike.

- **Menaxhimi me burimet njerëzore në sektorin publik**

Menaxhimi i burimeve njerëzore (MBNJ) është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit organizativ. Kjo lëndë fokusohet në shprehje të shumta të menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorin publik. Nëpërmjet kësaj lënde do të shqyrtohen teoritë dhe praktikat e MBNJ në kontekstin e faktorëve, të demokratizimit të shoqërisë, zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe globalizimit që drejtëpërdrejtë ndikojnë në zhvillimin e MBNJ. Njëkohësisht shkoqitet edhe roli i MBNJ në organizata me theks të rekrutimit, seleksionimit dhe testimit, trajnimit, zhvillimit dhe kompensimit të burimeve njerëzore në organizatë. Gjithashtu aktivitetet e rëndësishme të MBNJ përfshijnë edhe analizën dhe

përshkrimin e vendeve të punës. Të menduarit strategjik gjatë analizës së sfidave organizative dhe kadrovike u ofron zgjidhje konkrete udhëheqësve të sektorit publik. Kjo lëndë i përgatit studentët të jenë menaxherë të suksesshëm duke ekzaminuar teorinë, praktikën dhe politikën bashkëkohore të MBNJ.

- **Bazat e statistikës**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore të metodave themelore statistikore dhe zbatimin e tyre me qëllim që të ndjekin literaturën profesionale, që të mund në mënyrë koncize të paraqiten rezultatet dhe përfundimet e hulumtimit të bërë. Aspektet kryesore të studimit të kësaj lënde janë: përcaktimi i disiplinave, lidhja e të dhënave, analiza statistikore, zbatimi i metodave statistikore në fushën e shkencave humane, demonstrimi i të dhënave statistikore dhe lidhshmëria e statistikës me shkencat tjera.

- **E drejta administrative dhe procedura administrativë**

Lënda e studimit janë parimet e organizimit, punës dhe fushëveprimit të organeve administrative, aktivitetet themelore, që përbëjnë funksionin administrativ, aktet e organeve administrative dhe marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe administratës. Objektivat e programit të lëndës janë t'i bëjnë studentët: - t'i përcaktojnë dhe t'i kuptojnë termit e administratës dhe funksionit administrativ; - t'i njohin dhe analizojnë rregulloret ligjore që e rregullojnë organizimin dhe funksionimin e administratës publike në Republikën e Maqedonisë; - t'i shohin aktivitetet themelore të funksionit administrativ; - të bëjnë dallimin ndërmjet llojeve të akteve të administratës dhe të tejkalojnë hapat e parë në krijimin e akteve të tilla; - t'i studiojnë llojet e mbikëqyrjes administrative; - t'i kuptojnë mekanizmat e kontrollit mbi administratën dhe përgjegjësinë e tij ndaj organeve të tjera shtetërore, por edhe për klientët e saj - përdoruesit e shërbimeve të saj; - të fitojnë aftësi dhe shkathtësi për punësim në të ardhmen në organet e administratës së Republikës së Maqedonisë, organizatat joqeveritare, institucionet dhe të gjitha institucionet në të cilat zgjidhen çështjet e natyrës juridike administrative.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin që sistemet e menaxhimit të sigurisë do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikën relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Sistemi i nëpunësve administrativ në RMV**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi për t'i analizuar faktorët që ndikojnë në sjelljen e nëpunësve publikë dhe mekanizmat për përmirësimin e efikasitetit të shërbimit civil dhe llogaridhënies ndaj publikut.

- **Buxhetimi dhe financat publike**

Studentët fitojnë njohuri konceptuale dhe përmbajtësore në fushën e financave publike, që përfaqësojnë një marrëdhënie ndërmjet qytetarëve (si individë - obligacione tatimore dhe përdoruesit e shërbimeve publike dhe mallrave). Në të njëjtën kohë, studentët duhet të studiojnë dhe të kuptojnë politikën fiskale, procedurat dhe instrumentet fiskale për realizimin e marrëdhënieve midis palëve të interesuara në fushën e financave publike.

- **Metodat kualitative dhe kuantitative në shkencat shoqërore**

Qëllimi i lëndës është që të fokusohet në dy qasje të përgjithshme për analizën e të dhënave, domethënë, sasiore dhe cilësore. Në kushtet e analizës sasiore fokusohet në përdorimin e analizës statistikore në aspektin e analizës cilësore, të cilat janë përcaktuar si ato qasje që nuk përfshijnë qasjet sasiore - apo qasjeve që nuk përdorin manipulime numerike. Ai gjithashtu do të analizojë këtë lëndë dhe do t'i prezantojë rastet studimore, metodat e hulumtimit, qasjet kërkimore kërkimore, zbatimin e dizajnit empirik, dhe analizën multivariate.

- **Udhëheqja organizative në sektorin joqeveritar**

Ky modul është dizajnuar për të trajnuar studentët të përdorin mjete, mundësi dhe korniza për zbatimin e strategjive efektive në Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC). Temat e ndryshme përfshijnë kornizat konceptuale për të kuptuar rolin e lidhshimit strategjik, aftësitë analitike për zhvillimin dhe vlerësimin e strategjive dhe qasjeve për të punuar me grupe të ndryshme interesi, në mënyrë që të mobilizohen angazhimet dhe metodat për të udhëhequr dhe arritur ndryshimet. Është gjithashtu një modul multidisiplinar që hulumton mjedisin historik, politik, ligjor, etik dhe shoqëror në të cilin funksionojnë OSHC-të. Si rregull, çdo OSHC duhet të ketë një organ i pavarur drejtues (një bord ose një bord drejtuesish (MA) që menaxhon organizatën dhe merr vendime strategjike.) Ky modul merret me rolin e

menaxherit, domethënë drejtorit ekzekutiv (s) në organizim, në procesin e vendimmarrjes dhe në menaxhimin e personelit, në përputhje me normat ligjore, si dhe në përputhje me misionin dhe qëllimet strategjike të organizatës. Për më tepër, moduli mbulon marrëdhënien midis MA dhe ID dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e organizatës. Moduli shqyrton një gamë të gjerë burimesh, duke filluar nga qasjet e përcaktuara mirë në planifikimin dhe menaxhimin strategjik në praktikën më të mira, deri në përdorimin e përvojës së nxënësve me të, duke përfshirë një përshkrim të dallimeve në mes udhëheqjes dhe udhëheqjes, përvojave dhe shembujve të ndërtimit të ekipeve të suksesshme, me një theks të veçantë në aftësitë që një lider duhet të ketë për të qenë në gjendje të udhëheqë ekipin drejt suksesit.

- **Menaxhimi i projekteve dhe menaxhimi i granteve**

Ky modul merrret me planifikimin, implementimin dhe komunikimin efektiv të projekteve dhe ideve të projektit, të cilat janë me rëndësi të veçantë për të gjitha llojet e OSHC-ve. OSHC-të vazhdimisht duke marrë iniciativa të reja, të ofrojnë shërbime të reja, zhvillimin e qasjeve kreative në ofrimin e shërbimeve, të lë me testament komponente të reja, hapjen e objekteve të reja, qendrat, etj, futjen e teknologjive të reja, në mënyrë që t'i përgjigjet ndryshimit të mjedisit dhe kërkesat e grupeve të synuara. Ky modul ofron një hyrje në konceptet bazë dhe metodat e menaxhimit të projektit dhe u siguron studentëve mjete praktike që do t'i përgatisin ata për të qenë menaxherë të suksesshëm të projektit. Për më tepër, moduli përfshin një analizë të nevojave dhe problemeve, duke përdorur analizën e të dhënave të politikave apo kushte të ndryshme, nevoja për të krijuar partneritete, përdorimin e mjeteve të bindjes dhe të negociatave, dhe aftësitë e prezantimit. Kur punojnë në projekte specifike, studentët do të kenë mundësi për të përmbushur sfidat në përdorimin e disa mjeteve të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve, e përdorur më gjerësisht nga donatorët ndërkombëtarë dhe për të nxjerrë përfundime se aftësi ose njohuri duhet të përmirësohet.

- **Menaxhimi financiar dhe efikasiteti në përdorimin e burimeve të organizatave të shoqërisë civile**

Objektivat e programit të lëndës: Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me standardet dhe praktikën në performancën financiare të OSHC-ve, metodat e përdorimit të fondeve dhe me teknika të tjera të përshtatshme për menaxhimin e llogaridhënies në operacionet financiare të OSHC-ve duke përfshirë rishikimin dhe analizën e aspekteve teknike të kontabilitetit dhe përgatitjes, si dhe interpretimin e pasqyrave financiare. Koncepti i shfrytëzimit të eficientës së resurseve paraqet bazat e parimeve dhe procedurave, si dhe mundëson vendosjen e një kuadri racional për alokimin e burimeve. Kursi siguron një ekuilibër të përshtatshëm midis teorisë dhe praktikës, një rishikim të studimeve të rasteve të ndryshme dhe është hartuar për të stimuluar interesin e studentëve.

- **Menaxhmenti strategjik në sektorin publik dhe jofitimprurës**

Qëllimi i lëndës është tu ofrojë studentëve njohuri për analizën bashkëkohore të menaxhimit strategjik dhe modeleve të menaxhimit strategjik, veçanërisht me analizën mjedisore, formulimin e misionit, qëllimet, strategjinë, zbatimin dhe vlerësimin e performancës dhe kontrollit të organizatës.

- **Punim diplome**

Ky është një aktivitet lidhur me punimin e diplomës dhe projekt profesional. Nga studentët kërkohet ta shkruajnë një projekt që zakonisht lidhet me punën e diplomës, të punohet struktura e projektit, të bëhet një hulumtim dhe të shkruhet raporti.

- **Sistemet politike bashkëkohore**

Synim parësor i lëndës Sistemet politike bashkëkohore është t'i pajisë studentët me njohuri rreth funksionimit të sistemeve politike që hasen sot në mbarë botën, duke i përfshirë këtu jo vetëm sistemet politike që konsiderohen si demokratike. Lënda është strukturuar asisoj që të pajisen studentët me njohuri përkatëse teorike rreth teorive dhe koncepcioneve bazë mbi sistemet politike, duke i njoftuar ato njëkohësisht edhe me funksionimin praktik të më tepër sistemeve politike nga bota. Shikuar nga ky këndvështrim, si qëllime të veçanta të kësaj lënde mund të theksohen: - Studentët të njoftohen me sistemet politike nga këndvështrimi i nocionit, specifikave dhe zhvillimit historik të tyre. - Studentët të pajisen me njohuri themelore rreth teorive dhe koncepcioneve kryesore mbi sistemet politike - Studentët të pajisen me njohuri mbi qasjet kyç ndaj klasifikimit të sistemeve politike. - Studentët të aftësohen që t'i identifikojnë specifikat e sistemeve të veçanta politike.

- **Mirëqeverisja dhe përgjegjësia shoqërore**

Në këtë lëndë, studentët do të fitojnë njohuri për karakteristikat themelore të mirëqeverisjes në institucionet e Bashkimit Evropian. Sistematikisht, do të analizohet Bashkimi Evropian dhe projekti i integritit ekonomik dhe politik të Evropës. Leksionet, do të trajtojnë analizën e institucioneve dhe politikave të integritit në Evropë. Gjatë semestrit studentët do t'i analizojnë politikat publike (bujqësia, politika rajonale, politika e përbashkët e jashtme dhe e

sigurisë). Gjithashtu, në këtë lëndë do të analizohen mangësitë demokratike dhe tjetërsimi i udhëheqësve evropianë nga qytetarët e Bashkimit Evropian.

- **Menaxhimi i konfliktit, shkathtësitë e komunikimit dhe negociimit**

- Kjo lëndë e përfshinë trajtimin efektiv të konflikteve në vendin e punës, ndërmjet grupeve të ndryshme, kompanive, departamenteve qeveritare dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile (OSHC). Studimi i konflikteve dhe menaxhimi efektiv i tyre epërfshinë analizën e konfliktit, kuptimin e dinamikave të grupeve të ndryshme të interesit dhe përcaktimin e metodave të përshtatshme për trajtimin e tyre. - Menaxheri i OSHC-ve, qoftë nëse merret me menaxhmentin, politikën apo financat, është thirrur të menaxhojë, ose të angazhohet në adresimin e një game të gjerë konfliktesh. Konflikti është kudo, brenda dhe ndërmjet organizatave dhe institucioneve, në mes të niveleve të ndryshme të autoriteteve qeveritare, në mes të grupeve të ndryshme të interesit dhe institucioneve qeveritare, qytetarëve dhe institucioneve të tjera. Rritjen e kompleksitetit dhe marrëdhënie- konfliktet me çështje të ndryshme dhe probleme që janë të zakonshme për shumë grupe të ndryshme të interesit, rrit përgjegjësinë dhe sfidë për OJQ-të për të adresuar në mënyrë adekuate ato. Në një rajon si BE, është e nevojshme që udhëheqësit / menaxherët e OJQ-ve të dinë se si të merren me konfliktet. - Nëpërmjet studimeve të rasteve, diskutimeve, debateve dhe simulimeve, studentët do të kenë mundësi të përgatitenteorikisht dhe praktikisht për zgjidhjen e konflikteve, por në të njëjtën kohë do të punojnë në zhvillimin e shkathtësive negociuese dhe bindëse, si dhe aftësitë lehtësuese që një menaxher bashkëkohor është e nevojshme t'i zotëroj ato. Në të njëjtën kohë, këto aftësi janë të domosdoshme për gjenerimin e mbështetjes publike dhe komunikimin efektiv me grupet e ndryshme të interesit, të cilat janë bazë për suksesin e OJQ-ve.

- **Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i vullnetarëve**

E projektuar kryesisht për menaxherët e OSHC-ve, kjo lëndë ofron një pasqyrë të plotë të dinamikës së burimeve njerëzore. Lënda merret me funksionet themelore të menaxhimit të burimeve njerëzore (HRD), të tilla si rekrutimi i personelit, zhvillimin e karrierës, stafin e vlerësimit, duke dhënë reagime dhe dizajn edhe përshkrimin të punës. Lënda, gjithashtu merret me hulumtimin e çështjeve, që përfshijnë diversitetin dhe identitetin në punën dhe kulturën organizative, rolin e ekipit të komunikimit, iff-ve dhe çështje të tjera të rëndësishme në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore . Natyrisht, si një pjesë e pashmangshme e punës së OSHC-ve është përfshirja e vullnetarëve, si një burim i madh i aktivistëve në OSHC-të. Lënda, do të përfshijë punën praktike përmes diskutimit të rasteve studimore dhe një pasqyrim i përvojës së studentëve. Përqëndrohet në udhëheqje të organizatave që mbështeten në vlerat dhe në rastin për të bërë krahasime me praktikën në këtë fushë, në publik, fitim dhe shoqërinë civile.

- **Rregullimi ligjor dhe etika për organizatat e shoqërisë civile**

Ky modul është hartuar për të shqyrtuar të gjitha çështjet ligjore dhe etike me të cilat përballen OSHC-të. Fokusi i këtij moduli është një pasqyrë e të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore, që lidhen me punën e OSHC-ve, veçanërisht në aspektin e strukturës, qeverisjes, sjelljes organizative dhe llogaridhënies. Është me rëndësi të veçantë që studentët ta kuptojnë lidhjen midis etikës në sjelljen e OSHC-ve dhe imazhin e organizatave individuale, si dhe të sektorit në tërësi.

- **Sigurimi i fondeve për OJQ-të**

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e

profesioneve të tyre të ardhshme. Ata do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën maqedonase për fillestar 1 përfshin: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të vecanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përsëritjet, prezantimin si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund edhe të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara si dhe detyrave të vazhdueshme përmes të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Programi për Gjuhë maqedonase për fillestarë 2 përfshin: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi I aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përsëritimi I personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione) të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për një kurs të shkallës së dytë per fillestarë,ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive e interesave të studentëve.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione) të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për një kurs të shkallës së dytë per fillestarë,ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive e interesave të studentëve.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 1**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 2**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 3**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 4**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze 5**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbytjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Gjuhë angleze 6**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbytjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Të folurit publik**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të të folurit publik dhe llojet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme për përgatitjen dhe dhënien e llojeve të ndryshme të fjalimeve, aftësi për ta analizuar publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalime të

kolegëve.

- **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Nga kjo lëndë studentët: do të përfitojnë shkathtësi për diskutim dhe argumentim efektiv si dhe do të zhvillojnë vetëbesim për të folur para publikut; do të përpilojnë, do të zhvillojnë dhe do të ushtrojnë prezantimin e argumenteve në mënyra të ndryshme përfshirë punën individuale, në çifte dhe prezantime në grupe; do të mësojnë të përdorin retorikë bindëse, me qëllim të gjetjes së argumenteve që mbështesin një pozitë të caktuar lidhur me temat aktuale; ndjekja e kësaj lënde do t'u mundësojë të njihen në mënyrë më të hollësishme me proceset e debatit formal, gjegjësisht me stilin parlamentar britanik për debate;

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Aftësitë e komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të mësojnë aftësi ndërpersonale siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkruarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidhësi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezume, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që t'i informojë studentët me aplikacionin Microsoft Excel dhe duke shfrytëzuar mundësitë që ofron ky aplikacion të jenë në gjendje të kryejnë detyra të avancuara të cilat janë ngushtë të lidhura me programin fakultativ të tyre.

- **Aftësitë të avancuara të TI-së**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë studentët me mundësitë që ato i ofrojnë; T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'ju mundësojë që këto aplikacione edhe t'i aplikojnë në jetën e përditshme; T'u mundësojë studentëve të punojnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word i avancuar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it dhe PowerPoint-it. Ky kurs gjithashtu u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme si dhe detyra të veçanta komplekse të cilët janë të lidhura me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications); T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth Google Docs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre; T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me bazat e të dhënave.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i kësaj lënde është hartimi dhe përpunimi i grafikave raster dhe vektor përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Publikimi ueb**

Zhvillimi i një ueb faqeje qoftë edhe e thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë faqe ueb përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, sustave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e destinuar për ueb dhe për t'iu mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Fireworks gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e grafikës për ueb.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuha shqipe për qëllime specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me gabimet më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim në rrethana specifike. Studentët do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyn në përdorim, në mënyrë që mund ti përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjese të shkruar do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pas kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimin të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë

kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e lëndës janë: T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; Legjislativi ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; Mjedi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; Njoftimi me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; Njoftimi me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron mësim praktik të orientuar drejt rezultateve për kërkim. Po ashtu lënda i aftëson di ta fitojnë dhe si ta mbajnë vendin e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë aftësi të përshtatshme për vende pune moderne. Detyrë kryesore do të jetë përpilimi i CV, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, aftësitë për të intervistuar, komunikimi zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile oficiale për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do t'i përfshijë kjo lëndë janë: si të bëhet vetëvlerësimi, si të menaxhohet konflikti midis dy zyrave dhe si të kërkohet në mënyrë aktive promovimi. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jene të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të mbrendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Dhe do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 1**

Lënda fokusohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posaçme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shkathtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren rrjedhin nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekste nga botues të mëdhenj, si dhe tekste dhe materiale autentike. Thëks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.

- **Gjuhë angleze për administratë publike, shkenca politike dhe komunikim 2**

Lënda fokusohet në përmirësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze në tërësi, përvetësim të një terminologjie të posaçme nga lëndët profesionale të këtyre fushave, zhvillim dhe përmirësim të shkathtësive akademike të të shkruarit dhe të të lexuarit, si dhe diskutim tekstesh dhe përshkrime nga fusha e administratës publike, shkencave politike si dhe komunikimit dhe raporteve ndërkombëtare. Materialet që përdoren rrjedhin nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe tekste nga botues të mëdhenj, si dhe tekste dhe materiale autentike. Thëks i veçantë në lëndën në fjalë i kushtohet terminologjisë profesionale për qëllime komunikimi e cila do të jetë e zbatueshme gjatë ndërtimit të karrierës së studentëve.

- **E drejta e punës dhe marrëdhëniet e punës**

E drejta e punës është një disiplinë e veçantë dhe e pavarur e së drejtës në sistemin ligjor. Subjekti themelor i studimit dhe rregullimit është marrëdhëniet e punës në vetvete. Programi i lëndës E drejta e punës përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë - Çështjet e Përgjithshme dhe Themelore të Ligjit të Punës dhe Pjesa e dytë - Marrëdhëniet e

punës. Pjesa e parë mbulon çështje të përgjithshme-teorike si: lënda, përkufizimi, kuptimi, vendi në sistemin ligjor, karakteristikat, lidhja me ligjin e punës me disiplina të tjera ligjore, zhvillimi, burimet vendore dhe ndërkombëtare. Përveç vërejtjeve hyrëse, në këtë seksion, vëmendje e konsiderueshme u është kushtuar marrëveshjeve kolektive dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

- **Sociologjia e teknologjive të informacionit**

Studentët fitojnë njohuri për sociologjinë e arsimit, si një disiplinë e veçantë e sociologjisë, për të zhvilluar mendimin kritik në to dhe për të qenë në gjendje të merren me hulumtimet mbi fenomenet arsimore.

- **Sistemi administrativ i BE-së**

Lënda merret me zhvillimin e një sistemi të së drejtës administrative të BE-së. Ajo fokusohet në përkufizimin dhe tiparet kryesore të së drejtës administrative të BE-së, çështjet relevante në lidhje me përgjegjësinë financiare të administratës për veprimtari të paligjshme, zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në të drejtën administrative, qasjen në gjykatat administrative, zhvillimi i fundit dhe i ardhshëm i së drejtës administrative në BE, roli dhe kontributi i gjykatave dhe i Ombudsmanit Evropian, etj. Studimet e rasteve, do të përdoren për të ilustruar vendin dhe rolin e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe Gjykatës Administrative të BE-së në procesin administrativ.

- **E drejta administrative në BE**

Lënda merret me zhvillimin e një sistemi të së drejtës administrative të BE-së. Ajo fokusohet në përkufizimin dhe tiparet kryesore të së drejtës administrative të BE-së; çështjet relevante në lidhje me përgjegjësinë financiare të administratës për veprimtari të paligjshme; zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në të drejtën administrative, qasjen në gjykatat administrative; zhvillimin e fundit dhe e ardhshëm të së drejtës administrative në BE; rolin dhe kontributin e gjykatave dhe t Ombudsmanit Evropian, etj. Studimet e rasteve do të përdoren për të ilustruar vendin dhe rolin e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe Gjykatës Administrative të BE-së në procesin administrativ.

- **Teoritë dhe praktikat e qeverisjes ndërkombëtare**

T'uë ofrojë studentëve një pasqyrë kritike të proceseve kryesore në sistemin e qeverisjes globale. Lënda fokusohet në analizën e teorive themelore të qeverisjes globale. Përmes lëndës, studentët do të kenë mundësinë të shqyrtojnë në mënyrë kritike mençurinë konvencionale, si dhe të fitojnë një kuptim kritik të qeverisjes globale - si në teori ashtu edhe në praktikë. Lënda shqyrton fusha të ndryshme të politikës globale për të vlerësuar se si ajo përshtatet me ndjenjën e zhvillimeve bashkëkohore në këtë arenë me shpejtësi në rritje, duke përfshirë terrorizmin, shëndetin, të drejtat e njeriut, internetin, mjedisin etj. Lënda synon t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri se si punon qeverisja globale dhe si mund të analizohet arena komplekse e ndërveprimit politik global në një mënyrë sistematike të informuar teorikisht.

- **Politika e Evropës dhe Bashkimi Evropian**

Kjo lëndë i referohet njohjes së konceptit në shkencat politike krahasuese në studimin e Evropës bashkëkohore. Kursi kërkon njohuri paraprake të koncepteve themelore dhe metodave në shkencat politike dhe njohuritë e historisë së Evropës pas Luftës së Dytë Botërore. Lënda, do të ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë të lëndës, ne do të fokusohemi në politikën evropiane në nivelin mbikombëtar të kontekstit historik, institucioneve politike dhe politikave të Bashkimit Evropian. Në pjesën e dytë të lëndës, do të studiohen teoritë kryesore të politikës krahasuese që mund të ndihmojnë në kuptimin e ndryshimeve në institucionet, sjelljet politike dhe politikat në vendet evropiane dhe në BE. Gjatë ndjekjes së lëndës, do të njoftoheni me disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet Evropa dhe BE sot, do të adresohen dhe do të analizohen me kujdes një seri debatesh bashkëkohore dhe politike.

- **Menaxhimi i projekteve dhe menaxhimi i granteve**

Ky modul merret me planifikimin, implementimin dhe komunikimin efektiv të projekteve dhe ideve të projektit, të cilat janë me rëndësi të veçantë për të gjitha llojet e OSHC-ve. OSHC-të vazhdimisht duke marrë iniciativa të reja, të ofrojnë shërbime të reja, zhvillimin e qasjeve kreative në ofrimin e shërbimeve, të lë me testament komponente të reja, hapjen e objekteve të reja, qendrat, etj, futjen e teknologjive të reja, në mënyrë që t'i përgjigjet ndryshimit të mjedisit dhe kërkesat e grupeve të synuara. Ky modul ofron një hyrje në konceptet bazë dhe metodat e menaxhimit të projektit dhe u siguron studentëve mjete praktike që do t'i përgatisin ata për të qenë menaxherë të suksesshëm të projektit. Për më tepër, moduli përfshin një analizë të nevojave dhe problemeve duke përdorur analizën e të dhënave të politikave apo kushte të ndryshme, nevoja për të krijuar partneritete, përdorimin e mjeteve të bindjes dhe të negociatave dhe aftësitë e prezantimit. Gjatë punës në projekte konkrete, studentët, do të kenë mundësinë të përballen me sfidat e përdorimit të disa mjeteve të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve më të përdorura gjerësisht nga donatorët ndërkombëtarë dhe për të nxjerrë konkluzione se cilat aftësi, përkatësisht dije duhet t'i përmirësojnë.

- **Demografia sociale**

Përbërja dhe lëvizja e popullsisë në masë të madhe i përcakton nevojat dhe potencialet e çdo komuniteti lokal, rajoni ose shoqërie. Kështu, pamja demografike dhe ndryshimet gjithashtu përcaktojnë sfida specifike, për të cilat duhet të përgjigjet praktika e punës sociale dhe sistemeve sociale të punës sociale.

- **Analiza e kostove dhe përfitimeve**

Kjo lëndë e lidh teorinë ekonomike me analizën politike, duke përdorur një mjet të njohur si analiza e kostos dhe përfitimit. Qëllimi i analizës kosto-përfitim është matja e efikasitetit ekonomik të projektit, duke ofruar një përshkrim formal të kostove dhe përfitimeve të lidhura. Analiza e kostos dhe përfitimit është bërë një analizë standarde e politikave praktike. Ky kurs do t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të nevojshme për të analizuar dhe kryer kritikisht analizën e kostos dhe përfitimeve të projekteve specifike, ose politikave publike.

- **Menaxhimi i ndryshimeve**

Të njihen studentët me aftësitë e menaxhimit të përshtatshëm, praktik dhe të zbatueshëm. Të përmirësohet vetëbesimi i nxënësve për të përdorur mjetet e menaxhimit të ndryshimeve dhe modelet për hartimin e planeve të përshtatshme të ndryshimit për vendin e tyre të punës. Të njihen studentët me teorinë dhe praktikën bashkëkohore në proceset bashkëkohore të menaxhimit të ndryshimeve dhe gamën e mjeteve dhe metodave në dispozicion për t'i adresuar ndryshimet, sfidat dhe problemet.

- **Shoqëria civile dhe politikat zhvillimore**

Ky lëndë fokusohet në hyrje në teorinë e krijimit të shoqërisë civile, duke përcaktuar zonën që përfshin shoqërinë civile, aktorët kyç, ndërveprimet me sektorët e tjerë në vend, rolin dhe strukturën e shoqërisë civile dhe mënyrat e punës, karakteristikat e shoqërisë civile në Maqedoni dhe në rajon, strategjitë për qëndrueshmërinë e saj, si dhe mënyrat e ndikimit të politikave dhe proceseve demokratike. Në fushën e zhvillimit, kjo lëndë, do të japë një prezantim të koncepteve kyçe të zhvillimit, teoritë dhe qasjet, si dhe sfidat që varfërimi dhe prapambetja në zhvillimin e imponon mbi ata që punojnë në agjencitë donatore, OSHC-agjencitë e zhvillimit të shtetit, fondacionet dhe institutet kërkimore.

- **Menaxhmenti i sektorit social**

Lënda do të trajtojë konceptet dhe mjetet që lidhen me menaxhimin e organizatave shoqërore, si dhe konceptin e ndikimit kolektiv. Lënda synon t'i ekspozojë studentët në një perspektivë menaxhimi, që është një alternativë ndaj qasjeve tradicionale të menaxhimit të organizatave shoqërore - një qasje të qeverisjes shoqërore bazuar në një koncept të vetëm të një roli profesional.

- **Organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare**

Kjo lëndë mbulon një duzinë tema të rëndësishme teorike, që kanë të bëjnë me institucionet ndërkombëtare, zhvillimin historik dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare, funksionet dhe kompetencat. Kjo lëndë e analizon rolin e institucioneve që luajnë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve kolektive në politikën globale. Lënda fokusohet në rolet më të rëndësishme të institucioneve ndërkombëtare që kanë në botë, duke filluar nga paqja dhe siguria, zhvillimi ekonomik, të drejtat e njeriut, mbrojtja dhe mbrojtja e mjedisit. Këtu po bëhen përpjekje për të krijuar organizata ndërkombëtare, suksese dhe dështime si dhe sfida. Rëndësi e veçantë u është dhënë organizatave politike (OKB, BE), organizatave të sigurisë (NATO-s, OSBE-së), organizatave rajonale (Organizata e Shteteve Amerikane, Bashkimi Afrikan, Lidhja Arabe, etj), organizatave financiare (FMN, Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, etj) dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare.

- **Zhvillimi i qëndrueshëm**

- Qëllimi i studimit të zhvillimit të qëndrueshëm është që studentët të fitojnë njohuri të plota në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm, si një koncept të ri të zhvillimit, që imponohet në skenën globale dhe mundëson mbijetesën në planetin Tokë. - Me përfundimin e kësaj lënde studentit, do t'i kuptoj arsyet për lindjen e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, do të jetë në gjendje për të shpjeguar rëndësinë dhe superioritetin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, do të di për problemet globale mjedisore, do të jetë në gjendje t'i veçojë parimet dhe dimensionet e qëndrueshmërisë, do të ketë njohuri për konferencat ndërkombëtare të mbajtura për zhvillimin e qëndrueshëm dhe dokumentet e miratuara, do të njihet me organizatat ndërkombëtare me një mandat për të vepruar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, do të jetë në gjendje lidhjet përvetësojë politikat e BE-së për zhvillimin e qëndrueshëm, do të dinë se si RM-ja ndërton politika për zhvillimin e qëndrueshëm, do të jetë në gjendje ta shpjegojë nevojën e aktivitetit ekonomik, duke i respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë që të rrisë konkurrencën e biznesit. - Studimi i kësaj lënde, do të kontribuojë në drejtim të fitimit të njohurive më të thella të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar, Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të saj, si dhenë Republikën e Maqedonisë.

- **Organizatat ndërkombëtare: menaxhimi dhe funksionet**

Kjo lëndë i trajton çështjet teorike në lidhje me organizatat ndërkombëtare në nivel universal dhe rajonal, zhvillimin e tyre historik, rolin, funksionet dhe kompetencat. Vëmendje e veçantë i kushtohet çështjes së rolit të tyre në zgjidhjen e çështjeve kolektive dhe problemeve në politikën globale. Fokusi është në rolin e tyre në sferën e paqes dhe sigurisë, zhvillimit ekonomik, të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Fokusi është vendosur në organet kryesore të themeluara brenda organizatave përgjegjëse për realizimin e qëllimeve të përcaktuara.

- **Etika në administratën publike**

Qëllimet e planprogramit të lëndës: - Të ketë njohuri dhe ta kuptojë semantikën dhe konceptet e moralit e të etikës, standardet e sjelljes, arsyetimin moral dhe filozofinë morale. - Të zhvillojë qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale. - Të formojë qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe atë shtetërore. - Të ketë aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike. - Ta ketë ndjenjën e karakterit të nevojshëm në profesionin e administratorit. - Të njihet me literaturë për etikën në sferën a administrimit publik. - Të ketë gatishmëri për të përdorur mjete të komunikimit dhe të respektojë standardet etike në punën në institucionet shtetërore dhe aktorëve publikë.

- **Globalizimi dhe rrjetet sociale**

Qëllimet e programit të lëndës: - Studentët demonstrojnë dije që të kuptohen globalizimi dhe ndryshimet në shoqëri - Njohja e formës bashkëkohore për shfaqjen e faktorëve globalë. - Të fitojnë njohuri të metodave për hulumtimin e fenomeneve globale dhe shoqërisë së rrjeteve. - Të diskutojnë dhe në mënyrë të qartë t'i vëzhgojmë tiparet karakteristike të ndikimeve globale në nivel vendor. - Të mundësohet krijimi i mjedisit për një meditim konstruktiv dhe kritik. - Studentët të fitojnë vizione dhe t'i kuptojnë kushtet e globalizimit. - Të bëjnë hulumtime dhe të prezantojnë para kolegëve të tyre dhe në rrjetet sociale. - Të ketë ide, të japin iniciativa dhe për të zhvilluar një pjesë të rrjedhës së globalizimit nëpërmjet rrjeteve sociale në të cilin studentët janë aktivë. - T'i identifikojnë anët e mira dhe të këqija - etikën e rrjeteve sociale dhe globalizimit. - Facebook, Twitter, LinkedIn, Google + , You Tube, Instagram, Pinterest, Tumblr.

- **Psikologjia sociale**

Temat e diskutimit përfshijnë: perceptimin e personalitetit, marrëveshjet, formimin e qëndrimeve, vlerësimin dhe ndryshimet, paragjykimet, agresivitetin, të mësuarit social, dinamikën grupore, psikologjinë sociale dhe aplikimin shoqëror, ligjor dhe organizativ.

- **E drejta kushtetuese**

Përmes kësaj lënde studentët përfitojnë njohuri teorike dhe praktike nga e drejta kushtetuese si degë themelore e së drejtës, nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik dhe politik i shtetit si dhe nga kushtetushmëria dhe ligjshmëria si parime bazë të shtetit juridik.

- **Sistemi politik i RM-së**

Lënda ka për qëllim t'i pajisë studentët e studimeve deridiplomike në Fakultetin e administrimit publik dhe shkencave politike me njohuri të përgjithshme dhe specifike në lidhje me funksionimin e sistemit politik të Republikës së Maqedonisë në tërësi dhe funksionimin e institucioneve të veçanta të sistemit politik në Republikën e Maqedonisë. Në këtë drejtim si qëllime themelore të kësaj lënde mund të dallohen: - Studentët të pajisen me njohuri themelore për sistemet politike në përgjithësi dhe vendin e sistemit politik të Republikës së Maqedonisë në suazat e tyre - Studentet të njihen dhe të fitojnë dituri të mjaftueshme në lidhje me zhvillimin historik të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë - Studentët të njihen më hollësisht me funksionimin e elementeve të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë sot si shtet i pavarur dhe në të kaluarën si pjesë e ish Jugosllavisë, - Studentët të aftësohen t'i shfrytëzojnë informacionet që i kanë në dispozicion dhe dituritë e fituara e vlerësimet, - Studentët do të jenë në gjendje të përdorin informacionin në dispozicion dhe njohuritë e fituara për të siguruar opinione të bazuara në prova dhe vlerësime, - Të zhvillohen aftësitë komunikuese të studentëve dhe etj.

- **Shkathësi për menaxhimin e punëve në zyrë**

Studentët duhet të fitojnë njohuri themelore lidhur me organizimin dhe funksionimin efikas të punës në zyrë në organet shtetërore, ato vendore dhe institucionet e ndryshme dhe ndërmarrjet. Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që studentët të përgatiten në nivelin e duhur që të mund t'i realizojnë detyrimet në mënyrë efikase dhe me përgjegjësi. Njohuritë e fituara nga kjo lëndë do t'u mundësojnë studentëve që më lehtë të mësojnë detyrat e punës në administratën publike.

- **Partitë politike, zgjedhjet dhe modelet zgjedhore**

Lënda duhet t'u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme rreth lëvizjeve dhe ndryshimeve sociale. Bëhet fjalë për një objekt që kryen përpunimin e disa lëvizjeve themelore sociale, duke filluar me ato me të cilat të gjithë ne përballemi si

qytetarë dhe akademikë. Studentët, do të pajisen me një literaturë të plotë nga autorë vendas dhe të huaj, e cila do t'u mundësojnë atyre të zgjerojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre në fushat e temave që janë subjekt i analizave. Qëllimet e këtij kursi mund të theksohen si më poshtë: - Të iniciojë dhe të zhvillojë të menduarit kritik brenda grupit; - Studentët do të jenë në gjendje të përdorin informacionin e fituar për t'i përdorur ato për dhënien e notave dhe ndërtimin e argumenteve; - Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit të studentëve; - Studentët të kuptojnë se si po ndodhin lëvizjet politike në vende të ndryshme anembanë botës dhe mbi këtë bazë për të krijuar qëndrime kritike mbi lëvizjet politike në Maqedoni; - Studentët t'i kuptojnë temat që përpunohen në kuadrin e shkencave politike; - Studentët të jenë në gjendje të bëjnë dallimin midis demokracisë dhe sistemeve politike jodemokratike; - Studentët fitojnë aftësitë e nevojshme analitike për të kuptuar dhe vlerësuar lëvizjet politike dhe fenomenet brenda dhe jashtë vendit; - Studentët janë më të aftë të kuptojnë teknikat shkencore të punës me referencë të veçantë në metodën krahasuese etj.

- **Ekonomia sociale dhe e punës**

Kjo lëndë fokusohet në ekonominë e tregut të punës. Me këtë rast përpunohen determinantat e kërkesës dhe ofertës së tregut të punës, determinantat e pagave, dallimet e pagave në mes të grupeve, investimet në kapitalin njerëzor, punësimin dhe papunësinë. Qëllimi i këtij moduli është të punohet me raste studimi lidhur me tregun e punës në vendet e tranzicionit. Përmes ligjëratave dhe ushtrimeve studentët do të njoftohen me drejtimet kryesore të tregut të punës si dhe të fitojnë njohuri për hulumtime origjinale në këtë fushë.

- **Problemet politike të integritit në BE**

Proceset e zgjerimit të BE-së dhe integrimi në sistemin juridik-politik dhe strukturat institucionale të Bashkimit Evropian; zhvillimi i tyre historik, struktura ligjore e mekanizmave për zgjerimin në kuadër të marrëveshjeve të BE si dhe çështja politike që i ndjek këto procese-kushtëzimi i tyre gjeopolitik dhe gjeokulturor, si dhe kushtëzimi në aspektin e interesave nacionale të vendeve anëtare të BE-së dhe të vendeve që aspirojnë.

- **E drejta administrative në Bashkimin evropian**

Lënda merret me zhvillimin e sistemit të së drejtës administrative të BE-së. Ajo fokusohet në përcaktimin karakteristikave kryesore të së drejtës administrative në BE; në çështjet relevante që lidhen me përgjegjësinë financiare të administratës për aktivitete të paligjshme; zgjidhjen alternative të kontesteve në të drejtën administrative, qasjen në gjykatat administrative; zhvillimi i ardhshëm i së drejtës administrative i BE-së; roli dhe kontributi i gjykatave dhe Avokati Evropian i Popullit etj Studimet e rasteve do të përdoren për të ilustruar rolin e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe Gjykatës Administrative në proceset administrativ të BE-së.

- **Strategjitë për kërkim të punës**

Lënda është projektuar t'i inkurajojë studentët në procesin e planifikimit të hershëm dhe zhvillimit të karrierës. Procesi përfshin vetanalizimin e thellë, hulumtimin e karrierës, planifikimin dhe mbikëqyrjen e strategjive paraprake për punësim, etj. Filozofia e lëndës është që ky proces është i vazhdueshëm, sistematik dhe ka për qëllim një jetë të plotësuar me punë që është pjesë e planit të përgjithshëm për zhvillim profesional. Angazhimi në këtë proces duhet të jetë sfidues, interesant dhe studentët të jenë të kënaqur. Pëparësitë që kjo lëndë i ofron do t'i ndihmojë studentët gjatë kalimit të tranzicionit nga studenti në punonjës dhe do t'i ndihmojë të vendosin një rrugë më të drejtëpërdrejtë për të përmbushur qëllimet afatgjata të karrierës nëpërmjet parashikimit dhe mësimin të aftësive të nevojshme, kurseve dhe përvojës për punën fillestare e cila do të jetë pika më e mirë e fillimit të karrierës që studenti e planifikon.

- **Teoritë e sjelljes organizative**

Përmes kësaj lënde studentët do të njoftohen me strukturat dhe me funksionet e organizatave në sektorin publik dhe jofitimprurës dhe me sjelljen e njerëzve në këto organizata. Studentët nëpërmes kësaj lënde fillimisht do të mund t'i kuptojnë konceptet e organizimit dhe teknikat praktike për menaxhimin e organizatave në rrethana të ndryshme. Në fund të semestrit studentët duhet të kenë njohuri në fushat e mëposhtme: - Teoritë themelore dhe relevante në organizatat në sektorin publik, - Menaxhimi i personelit, - Shkathtësi për punë në grupe.

- **Menaxhimi politik**

Në kuadër të lëndës, studenti duhet: - Të përvetësojë njohuri themelore të termeve politikë dhe menaxhment; - Të njihet me mjetet themelore dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me dallimin e proceseve politike sipas kriteriumeve të ndryshme; - Të përfitojë njohuri adekuate për përgatitje të anketës dhe punës në terren; - T'i aplikojë njohuritë e fituara nga lëndët tjera dhe të ndërtojë një metodologji të posaçme për përpunimin e eseve-punimeve seminarike; - T'i analizojë proceset zgjedhore dhe mënyrën e realizimit; - Të përgatisë fjalim politik dhe të simuloj një ngjarje politike. - Të fitojë aftësi për pjesëmarrje aktive në debat të organizuar nga Bashkimi i studentëve; - Të fitojë aftësi për të përgatitur dhe për të marrë pjesë në projekte hulumtuese si dhe prezantim të rezultateve të kërkimit shkencor; - Të përcaktojë mënyra të ndryshme për përdorimin e burimeve shkencore, të mësojë e të lexojë selektivisht dhe t'i analizojë proceset politike në mënyrë krahasuese.

- **Planifikimi zhvillimor dhe vlerësimi i ndikimit të politikave publike**

Lënda ka për qëllim të njoftohen studentët me çështjet komplekse me të cilat përballen vendimmëmarësit dhe planifikuesit, si dhe të njihen me mekanizmat që përdoren për të sqaruar këto çështje nga hulumtuesit dhe praktikuesit në sektorin publik.

- **Politika sociale**

Qëllimet e programit të lëndës: • U mundëson studentëve t'i analizojnë faktorët institucionalë dhe politikë të cilët kanë formë të zhvillimit të shtetit social (në Britaninë e Madhe dhe shtetet tjera) në të kaluarën dhe gjithë ai formim në të tashmen; • U mundëson studentëve të kuptojnë se si funksionon shteti social, siç është e dhënë, si paguhet dhe cilat janë përfitimet nga ajo; • U mundëson studentëve të identifikojnë argumentet politike për dhe kundër ndodhjeve të fundit në fushat kyçe të politikës (siç janë politika shëndetësore, punësimi dhe politika sociale, politika e sigurimit, politika e strehimit dhe politika e së drejtës penale); • Të mundësohet zhvillim i aftësive për ta mësuar lëndën duke përfshirë interpretimin e të dhënave.

- **Rregullativa afariste qeveritare**

Ekonomia si tërësi ndikon në mënyrën se si ne kujdesemi në mënyrë efikase për planetin tonë, për të ardhmen që ne duam ta kemi si pjesë e tij, për burimet që kemi në dispozicion, për masën në të cilën kujdesemi për të varfrit dhe të pasurit. Por njëherësh ka nevojë të theksohet se parimet ekonomike dhe konceptet pavarësisht nga niveli i zhvillimit të ekonomisë nuk do ndryshohen. Nëpërmes kësaj lënde studentët fitojnë kuptim themelor të fenomeneve ekonomike, marrëdhënieve të biznesit me kapacitetet administrative të shtetit. Lënda jep informacion mbi marrëdhëniet e komunitetit të biznesit, sistemin administrativ dhe institucionet politike. Studentët të përdorin njohuritë për të paraqitur problemet aktuale socio-ekonomike.

- **Demokracia dhe shoqëria civile**

Studentët në këtë lëndë do t'i fitojnë aftësitë, njohuritë dhe qasjet në vijim: - Të kuptuarit e proceseve, teoritë dhe analizat empirike që lidhen me institucionet politike dhe sjelljen politike; - Aftësi për të zbatuar procesin e të menduarit kritik dhe aplikimin e metodave bazë të hulumtimit dhe analiza sasiore; - Fitimin e aftësive efektive të komunikimit me shkrim.

- **Sociologjia e punës dhe organizatave**

Qëllimet e programit të lëndës Studenti të jetë në gjendje: T'i zbatojë qëllimet e analizës sociologjike të punës. Të demonstrojë se e ka kuptuar zhvillimin historik të formave moderne të punës. T'i kuptojë ndryshimet shoqërore të stimuluar me proceset transformuese të punës dhe të globalizimit. T'i artikulojë sfidat dhe presionet e njerëzmit nëpër perspektivën e klasës, racës dhe seksit në planin kombëtar dhe ndërkombëtar, T'i artikulojë konceptet bazë të mendimtarëve më të rëndësishëm të sociologjisë së punës. Të'i kuptojë profesionet e veçanta. T'i kuptojë dhe t'i kritikojë reformat ekzistente në sferën e punës si dhe trendet menaxheriale

- **Analiza e opinionit publik**

Qëllimi i lëndës është që të përqëndrohet në dy metoda të përgjithshme të analizës së të dhënave, pra sasiore dhe cilësore. Në raport me metodën e analizës sasiore fokusohet në përdorimin e analizës statistikore në raport me analizën cilësore në të cilën përkufizohet si ato qasje në ato analiza në të cilat nuk janë përfshirë qasjet sasiore – ose qasjet të cilat nuk shfrytëzojnë manipulim numerik. Gjithashtu lënda do t'i analizojë dhe përmes studimeve të rastit do t'i prezantojë metodat e hulumtimit, disa pjesë të hulumtimit shoqëror shkencor, qasjet për dizajn hulumtues, zbatimin e dizajnit empirik si analizë multivariabile.

- **Puna sociale në sektorin e OJQve**

Të fitojë njohuri shkencore dhe të thelluara të qasjeve më të rëndësishme për problemet e të rinjve në shoqëri dhe të studiojnë mënyrat në të cilat grupet e ndryshme të të rinjve marrin pjesë në jetën shoqërore, ndërtimin e nënkulturave specifike dhe stilet e jetës. Studentët njihen me politikën rinore të shtetit.

- **TI në sektorin publik**

Lënda ofron një hyrje të gjerë në sistemet e informacionit, nga prizmi organizativ dhe social. Qëllimi është që studentët të fitojnë një baraspeshë të përshtatshme të perspektivave teknike dhe organizative, që do të shërbejnë si bazë për studime të mëtejshme në këtë fushë.

- **E drejta humanitare dhe roli i nëpunësve publik**

E drejta humanitare si lëndë paraqet një nga mundësitë e mira që studentët të njoftohen me tërësinë e rregullave, të cilat nga aspekti humanitar kanë për qëllim që t'i limitojnë efektet nga konfliktet e armatosura. Studentët do të kenë mundësi të dëgjojnë për masat e mbrojtjes së personave të cilët nuk kanë marrë pjesë apo nuk marrin pjesë në armiqësi dhe i kufizojnë mjetet dhe metodat e luftës. Veçanërisht, është i rëndësishëm roli i rregullave pozitive që

kanë të bëjnë me detyrimet e nëpunësve civilë në rast të konflikteve të armatosura.